



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator

Data: 2.2.2023

Nr: 4

Ora: 14:00

V E N D I M

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR.2, DATË 5.12.2020, TË KOMISIONIT RREGULLATOR, "PËR CAKTIMIN E PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES DHE TRAJNIMIT TË SHTETASVE QË MUND TË EMËROHEN KRYESISHT PËR PLOTËSIMIN E VAKANCAVE NË KZAZ DHE KQV

Në mbështetje të nenit 20, pikat 1, shkronja "a", nenit 29, pikat 5, 6, 7 dhe 8, dhe nenit 36, pika 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në udhëzimin nr.2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 5, hiqen fjalët "...ose Zyrave Rajonale Zgjedhore...".
 - b) Pas pikës 2, të nenit 6, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:
"2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t'u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar të KZAZ-së."
 - c) Në shkronjën "c", të pikës 2, të nenit 10, hiqen fjalët "...ose Zyrave Rajonale Zgjedhore...".
 - ç) Pas pikës 2, të nenit 11, shtohet pika 2.1 , me këtë përmbajtje:
"2.1 Me kërkesë të Komisionerit apo Nënkomisionerit, administrata e KQZ-së u vë në dispozicion dokumentacionin e plotë të paraqitur për çdo shtetas që ka shprehur interes për t'u emëruar kryesisht si anëtar apo sekretar të KQV-së."

Data: 2.2.2023 Nr: 4
Ora: 14:00



"Për disa ndryshime dhe shtesa në udhëzimin nr. 2, datë 5.12.2020, të Komisionit Rregullator, "Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancave në KZAZ dhe KQV"

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO

Kryetar

Arens ÇELA

Anëtar

Dritan ÇAKA

Anëtar

Helga VUKAJ

Anëtar

Muharrem ÇAKAJ

Anëtar